



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR MAT

Nr. Seria 000133

LEJE
PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
Nr. 10 Prot., datë 13 / 01 / 2026

Miratuar me:
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT LUMOR MAT
Nr.10, datë 29/12/2025

Emri i individit/subjektit: **“ALBCHROME” SH.P.K**
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT): **K11613001M**
Baseni Lumor: **MAT**
Kodi i Trupit Ujor: **-**
Qarku: **DIBËR**
Bashkia/ Njësia administrative: **Bashkia Burrel/ Njësia administrative Kosmi**
Koordinatat: **X= 497416 Y= 4605405 Z= 323 m**
Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji : **Qëllime Industriale (Larje minerali)**
Prurja mesatare vjetore: **$q_{mes}= 1.89$ l/s**
Prurja ekologjike: **NUK KA**
Sasia e ujit që jepet për përdorim: **$q_{ilog}= 1.89$ l/s**
Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka): **NUK KA**
Vendi ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer: **NUK KA**
Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: **Kanal (pas trajtimit)**
Sipërfaqja e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes) **NUK KA**
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): **SIPAS KUSHTEVE TË LEJES**
Periudha e vlefshmërisë: **5 VJET**
Hyrja në fuqi: **Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licensave dhe lejeve**

KRYETARI
TAULANT MALSHI



Kushtet e posaçme të lejes për përdorim burimi uhor nëntokësor

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë dhe mirëmbajë me shpenzimet e veta pajisjet për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organi përkatës që ka lëshuar lejen;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit uhor për hidroenergji, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo veprë marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
8. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes;
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
11. Të lejojë rrjedhën ekologjike, sipas specifikimeve në leje;
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin uhor në rast të një aksidenti, apo incidenti;
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin uhor në gjendjen e mëparshme;
14. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit uhor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur;
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet e tjera për veprimtarinë, të përcaktuara në ligjin për burimet ujore.